



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 19.05.2015, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për sistemin e depozitës për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2009 “Për standardizimin”, të ndryshuar”.
4. Projektligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.
5. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkja, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Arben Imami, Kejdi Mehmetaj dhe Edi Paloka.

**Të ftuar:**

Alba Thoma – drejtoreshë juridike  
Vaeld Zhezha – këshilltar i ministrit të Mjedisit për marrëdhëniet me parlamentin  
Elda Sotiri – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Integritimit Europian  
Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes  
Riza Hasanaj – drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit

Kostanca Dedja – drejtore për Çështjet Ligjore dhe Marrëdhëniet me Palët në  
Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit

## HAPET MBLEDHJA

**Majlinda Bregu** – Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për sistemin e depozitës për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë”, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2009 “Për standardizimin”, të ndryshuar”, projektligjin “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe çështje të tjera, në rast se kemi.

Do të fillojmë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2009 “Për standardizimin”, të ndryshuar”. Për shqyrtimin e këtij projektligji ka ardhur zëvendësministri i Ekonomisë, zoti Ervin Mete, bashkë me stafin e tij.

Zoti Mete, ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër, jashtë relacionit!

**Ervin Mete** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zyrtarisht urime për ditëlindjen!

Projektligji ka dy ndryshime të vogla:

Së pari, synon përputhjen me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”. Ata trajtoheshin jashtë statusit, por tani janë me status dhe në bazë të atij ligji rregullohet këtu.

Së dyti, ka një ndryshim në direktivën përkatëse në lidhje me notifikimin që bëhet për draftstandartet. Duke qenë se është ndryshuar në direktivë, është ndryshuar edhe në ligjin përkatës. Ka një trajtim të ndryshëm tashmë.

**Majlinda Bregu** – Domethënë, nuk prek asgjë substanciale.

A ka ndonjë pyetje? Nuk ka. Komentë? Nuk ka.

Drejtorja e Përafrimit të Legjislacionit shprehet se ka vetëm një rregullim, duhet të mbajë shkallë të synuar përafrimi dhe referencën e saktë ligjore, numrin e botimit në Fletore Zyrtare, si dhe seleksin e instrumentit ligjor të BE-së që ligji parashikon ta përafrojë. Pra, nuk ka ndonjë gjë tjetër. Besoj se këtë pjesë reference do ta merrni parasysh. Normalisht duhet t’ua ketë bërë edhe Ministria e Integritit si vërejtje. Nëse nuk e ka bërë, e ka Drejtorja e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend. E keni bërë ju, Elda?

**Elda Sotiri** – Po.

**Majlinda Bregu** – A jeni dakord me këtë projektligj? Dakord.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 19.05.2015, ora 12:20

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkëjau, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Arben Imami, Kejdi Mehmetaj dhe Edi Paloka.

**Të ftuar:**

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Elda Sotiri – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Integritimit Europian

**Majlinda Bregu** – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Zoti Mete, fjala është për ju.

**Ervin Mete** – Projektligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” synon nxitjen e investimeve të huaja dhe të brendshme të rëndësishme, private dhe publike, që konsiderohen me rëndësi strategjike për vendin. Janë disa elemente mbi bazën e të cilave vlerësohet rëndësia dhe më pas interesi publik i investimit, siç janë: koha e realizimit, punësimi, zhvillimi rajonal, teknologjitë e reja që ato ofrojnë dhe, mbi të gjitha, vlera e investimit. Janë dy nivele vlerash investimi: 3 milionë euro dhe 50 milionë euro, në bazë të të cilave investimi klasifikohet nëse është i asistuar apo i veçantë.

Synohet të targetohen katër nga vështirësitë që hasin investitorët në proceset e marrëdhënieve me shtetin dhe në përgjithësi me investimet e tyre. Shumë e rëndësishme është burokracia shtetërore dhe trokitja në shumë dyer. Vendosim një dritare unike, që është AIDA, për të pritur, trajtuar dhe asistuar investitorë, duke arritur, në raste të caktuara, edhe përfaqësimin e investitorëve në këto institucione. Kjo shoqërohet njëkohësisht me detyrimin e institucioneve përkatëse, ato që japin miratimet, autorizimet apo licencat, që t’i trajtojnë jo vetëm me përparësi, por brenda një afati kohor 15 ditë pune, duke shtuar edhe 15 ditë të tjera punë në raste të kompleksitetit të projektit. Në këtë mënyrë thjeshtohet koha dhe burokracia, si dhe vendoset një sistem transparent dhe me shpresë eficient për të pritur dhe asistuar investitorët.

Në të njëjtën kohë krijohet Komiteti i Investimeve Strategjike, i cili është një trupë e nivelit të lartë, e kryesuar nga Kryeministri, me përbërje zëvendëskryeministrin dhe një sërë ministrash, të cilët japin statusin e investimit strategjik, duke dhënë njëkohësisht edhe mesazhin e një mbështetjeje apo suportit të qeverisë për këtë projekt, çka shkon drejt synimit të shtyllës së dytë, garancinë shtetërore të projektit.

Në këtë linjë, në raste të veçanta, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, për projekte strategjike të veçanta dhe të rëndësishme mund të sillen kontrata, kur kërkohet nga investitori, për t’u miratuar në parlament.

Shtylla e tretë është mbështetja infrastrukturore. Ka qenë dhe mbetet problem i vazhdueshëm garancia që merr një investitor për mbështetjen infrastrukturore të shtetit. Ligji parashikon që, sipas rastit, mund të hyhet në një memorandum mirëkuptimi apo të merren nga ministritë përgjegjëse masat për mbështetjen infrastrukturore të investimit.

Shtylla e katërt është aksesin në tokë. Pra, ka një sërë regjimesh që rregullojnë aksesin në tokë, për shembull, në tokat bujqësore, në tokat ose ambientet që jepen me qira, pra ato që

menaxhohen nga Ministria e Ekonomisë e të tjerë me radhë. Ne synojmë të krijojmë një fond të pasurive të paluajtshme, që mund të përdoret për investitorët dhe të rregullohet në mënyra sesi vihet në dispozicion nëpërmjet garës, si dhe të strukturohet në mënyrë më të qartë dhe më shpejt mënyra sesi mund të mbështeten investitorët me pasuri të paluajtshme.

Kjo është në terma të përgjithshëm panorama e projektligjit.

**Majlinda Bregu** – Ne nuk hyjmë dot në diskutimin e projektligjit, sepse komisioni përgjegjës është ai i Ekonomisë.

Vazhdon ende diskutimi?

**Ervin Mete** – Përveç diskutimin në parim, dje ka filluar diskutimi nen për nen, ku ata kanë lënë disa çështje për t'u ndjekur nga Komisioni i Ligjeve dhe disa çështje që duan sqarime të mëtejshme.

**Majlinda Bregu** – Ky projektligj do të diskutohet në seancë ditën e enjte? Nuk kalon ditën e enjte në seancë, sepse vazhdon ende diskutimi nëpër komisione të tjera.

Do të ishte mirë që ne të kishim një mendim nga komisionet e tjera, sepse ligji është integral, ne nuk kemi mundësi sot që të japim një mendim, përveç pjesës së përputhshmërisë, që nuk besoj se ka gjë. Ky duhet të jetë një ligj që lihet në bazë të legjislacionit të çdo vendi.

Tani që po e shoh unë kam një sërë pyetjesh, të cilat nuk besoj se kemi mundësi t'u japim sot përgjigje, sepse, sigurisht, ky ligj nuk bëhet për të përcaktuar një limit të fondit që ne presim të vijë nëpërmjet investimeve, të paktën nga ajo që më ka dhënë Drejtoria e Legjislacionit, pra 1-1,2 miliardë euro gjatë periudhës afatmesme. Besoj se ky është parashikimi buxhetor që bëni ju, por nuk ka lidhje me projektligjin, sepse mund të mos jetë as 1 miliard, as 1 euro.

**Ervin Mete** – Ne nuk jemi shprehur për një vlerë të tillë.

**Majlinda Bregu** – Investimet e huaja kanë rënë në 30%, nëse nuk jam gabim. Pra, ka një ulje të investimeve të huaja.

Çështja është se ky ligj nuk është garancia për shtimin e investimeve të huaja, prandaj unë dua që ne ta shtyjmë dhe pasi të marrim mendimin e Komisionit të Ekonomisë dhe të Komisionit të Ligjeve ta kalojmë.

**Dedë Kasneci** – Komisioni shqyrton atë që ka sjellë Këshilli i Ministrave, pra vetëm ajo që vjen nga Këshilli i Ministrave. Më pas nga komisionet mund të trajtohen gjëra të përbashkëta.

**Majlinda Bregu** – Ne e dimë këtë, por nuk ka për të kaluar në seancë ditën e enjte.

**Dedë Kasneci** – Dakord, por nuk mund të pritët se çfarë thonë komisionet e tjera.

**Majlinda Bregu** – Në parim ne nuk kemi asgjë kundër, nuk bëhemi ne pengesë për të kaluar projektligjin në seancë nëse komisionet e tjera kanë mbaruar punë.

Gjithsesi, nëse doni e hedhim në votë.

Komisioni i Integrimi i qëndron variantit dhe propozimit të relacionit që do të merret nga Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni i Ligjeve, për aq kohë sa nuk ka as përputhje me *acque*-n. Pra, jemi dakord.

Faleminderit!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 19.05.2015, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për sistemin e depozitës për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkja, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Arben Imami, Kejdi Mehmetaj dhe Edi Paloka.

**Të ftuar:**

Alba Thoma – drejtoreshë juridike

Vaeld Zhezha – këshilltar i ministrit të Mjedisit për marrëdhëniet me parlamentin



**Majlinda Bregu** – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për sistemin e depozitës për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji nga Ministria e Mjedisit kanë ardhur zonja Alba Thoma, drejtoreshë juridike, si dhe zoti Vaeld Zhezha, këshilltar i ministrit të Mjedisit për marrëdhëniet me parlamentin.

Zonja Thoma, keni fjalën.

**Alba Thoma** – Si fillim, ju urojmë gëzuar ditëlindjen!

Projektligji është një iniciativë e Ministrisë së Mjedisit në kuadër të ndihmës që duhet t’i japim vendit për pastrimin nga të gjitha rrymat e mbetjeve. Në fakt, ky është një projektligj që nuk përfaqëson asnjë direktivë të BE-së apo rregullore, pra është thjesht ligj i brendshëm. Ky ligj është bërë për herë të parë dhe jemi bazuar tek eksperiencat e disa shteteve evropiane.

**Majlinda Bregu** – Çfarë do t’u bëni këtyre mbetjeve?

**Alba Thoma** – Bëhet fjalë që me anë të një mekanizmi financiar të mbetjeve të stimulohet rikthimi i tyre, me qëllim riciklimin, rikuperimin dhe çdo gjë tjetër. Ky është një ligj që, për mendimin tonë, do të zgjidhë një pjesë të mirë të problemeve të vendit, duke qenë se ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk është se pati një kontribut shumë të madh te menaxhimi i mbetjeve.

Në Komisionin e Ekonomisë kaloi pa problem, megjithëse ka një element financiar. Në lidhje me periudhën transitore, për komentim që ka bërë Drejtoria Juridike e Kuvendit, jemi dakord, sepse edhe ne kemi rënë dakord me Ministrinë e Financave që të mos kemi ndërhyrje.

**Dedë Kasneci** – Duke qenë se parashikohet kalimi në një sistem totalisht të ri, pra një pagesë e detyrueshme, gjykata ka vendosur disa kriterë. Pra, duhet një periudhë transitore, brenda të cilës të përgatitem operatorët, nuk mund të kalohet menjëherë në sistem, sepse ata duhet të vendosin linja të reja të prodhimit, të shpërndarjes. Prandaj ajo ka thënë se të paktën një periudhë njëvjeçare duhet të jetë. Prandaj ne sugjeruam që të parashikohet një periudhë transitore, pra është në linjë me legjislacionin evropian. Po të hyjë menjëherë në fuqi do të jetë totalisht i pazbatueshëm. Edhe përfaqësuesit e ministrisë thonë se janë dakord me këtë gjë.

**Alba Thoma** – Jemi dakord me këtë gjë, sepse do të ketë ndërhyrje në legjislacionin e brendshëm, pra do të hiqet TVSH-ja për pjesën e vlerës së depozitës. Ministria e Financave

është dakord. Ky ndryshim zakonisht bëhet në fund të vitit, pra ndryshohet ligji i TVSH-së. Kjo do të thotë se pas 1 korrikut të 2016-s mund të fillojë implementimi i ligjit. Kështu që dispozita transitorë do të jetë patjetër. Sugjerimi i kolegëve ka qenë e njëjtë me sugjerimet e ministrive të tjera.

**Majlinda Bregu** – Të njëjtin sugjerim ka edhe Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

A ka pyetje? Nuk ka. A ka komente? Nuk ka. Jeni dakord me projektligjin? Dakord.

Faleminderit që ishit të pranishëm!

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**